

Në bazë të nenit 61 paragrafit (7) të Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 161/19, 229/20, 3/25 dhe 74/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës, solli:

RREGULLORE

PËR MËNYRËN E REGJISTRIMIT TË FËMIJËVE TË CILËT NUK JANË TË PËRFSHIRË NË MËSIM, NDËRSA KANË KALUAR KUFIRIN E MOSHËS SË TEJKALUAR

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e regjistrimit të fëmijëve të cilët nuk janë të përfshirë në mësim në arsimin fillor, ndërsa kanë kaluar kufirin e moshës së tejkaluar

Neni 2

Me kufirin e moshës së tejkaluar nënkuptohet tejkalimi i moshës së përcaktuar me ligj për fillimin e arsimit fillor të detyrueshëm.

Neni 3

Nëse paraqiten fëmijë me moshë të tejkaluar, çdo shkollë është e detyruar t'i përfshijë këta fëmijë në procesin e rregullt mësimor.

Neni 4

Gjatë regjistrimit të fëmijëve me kufirin e moshës të tejkaluar në arsimin fillor, merret parasysh dokumentacioni që nxënësi posedon për arsimimin e tij të mëparshëm.

Neni 5

Fëmijët me moshë të tejkaluar përfshihen në arsimin fillor të detyrueshëm, i cili është i organizuar në tre periudha edukativo-arsimore:

periudha e parë – nga klasa e parë deri në të tretën;

periudha e dytë – nga klasa e katërt deri në të gjashtë;

periudha e tretë – nga klasa e shtatë deri në të nëntën.

Nëse fëmija, deri në momentin e regjistrimit, fare nuk ka ndjekur mësim, arsimin e fillon sipas programeve mësimore për klasën e parë.

Në varësi të moshës, nxënësi ndjek mësimin bashkë me nxënës të moshës së tij ose të përafërt, me çrast shkolla mban llogari, dallimin në moshë ndërmjet nxënësit të përfshirë dhe nxënësve të rregullt të mos tejkalohen dy vite, përkatësisht tre vite nëse përfshihet në klasën e gjashtë.

Nxënësi me kufirin e moshës së tejkaluar nuk mund të shpërndahet në periudhën e tretë, përveç në rast se posedon dëshmi – dëftesë për përfundimin e klasës së gjashtë, ndërsa për arsye të caktuara ka ndërprerë shkollimin pas përfundimit të klasës së gjashtë.

Nxënësit me kufirin e moshës së tejkaluar të cilët janë të përfshirë në periudhën e parë dhe të dytë ndjekin mësimin sipas programeve të përshtatura, ndërsa nxënësit në periudhën e tretë ndjekin mësimin sipas programeve të rregullta mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçar.

Neni 6

Nëse nxënësi ka qenë i regjistruar më parë në shkollën fillore, ndërsa më pas e ka braktisur, pas reregjistrimit në arsimin fillor, do të merret në konsideratë dëftesat e tij të fundit për përfundundimin e klasës.

Nxënësi nga paragrafi 1 i këtij neni regjistrohet në klasën tjetër, i udhëhequr nga dispozitat e nenit 5 të kësaj rregullore, me çrast përfshihet në paralele me nxënës të moshës së ngjashme, por jo më shumë se dy vjet dallim në raport me moshën e nxënësve të rregullt.

Neni 7

Nxënësi me kufirin e moshës së tejkaluar mund të përfshihet në procesin edukativo-arsimor më së voni deri në fund të muajit shkurt të vitit shkollor vijues.

Nëse në shkollë është parashtruar kërkesë për regjistrim pas afatit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, shkolla do të jetë e detyruar ta pranojë nxënësin dhe ta përfshijë atë në paralele në të cilën do të ndjekë mësimet si nxënës i rregullt me fillimin e vitit të ardhshëm shkollor, në të cilin rast procedura do të jetë në përputhje me dispozitat e nenit 5 të kësaj rregullore.

Në periudhën para fillimit të mësimet, shkolla është e detyruar ta përfshijë nxënësin në aktivitetet shkollore me qëllim të përshtatjes dhe integritetit më të lehtë dhe me sukses të nxënësit në procesin edukativo-arsimor dhe, nëse është e nevojshme, t'i ofrojë mbështetje të përkatëse për zotërimin e gjuhës në të cilën do të zhvillohet mësimi.

Neni 8

Në rastet kur është e nevojshme të kryhet verifikimi i njohurive të nxënësit për shkak të përfshirjes në klasën përkatëse, verifikimi realizohet me instrumente/teste të përcaktuara nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit (në tekstin vijues: Byroja).

Shkolla është e detyruar të dërgojë njoftim në Byronë për datën e realizimit të verifikimit, të paktën dy javë para realizimit të kontrollit.

Në ditën e realizimit të testimit detyrimisht merr pjesë përfaqësues i Byrosë, i cili i sjell instrumentet për verifikimin e njohurive të nxënësit dhe e ndjek realizimin e testimit.

Neni 9

Verifikimi i njohurive të nxënësit realizohet nga Komisioni për verifikimin e njohurive të nxënësit (në tekstin vijues: Komisioni), të formuar nga drejtori i shkollës.

Pas marrjes së instrumenteve për verifikim, Komisioni është i detyruar të nënshkruajë deklaratë nën përgjegjësi të plotë morale dhe penale, se testet nuk do të regjistrohen, fotografohen apo shpërndahen te persona të tretë.

Neni 10

Për regjistrimin e nxënësit deri në klasën e pestë, Komisioni përbëhet nga një bashkëpunëtor profesional pedagog ose psikolog dhe dy mësimdhënës të grupit klasor.

Neni 11

Për regjistrimin e nxënësit në klasën e gjashtë, Komisioni përbëhet nga një bashkëpunëtor profesional pedagog ose psikolog dhe dy mësimdhënës të mësimdhënës lëndore, përkatëse nga fushat e shkencave natyrore, matematikës dhe gjuhës amtare nga shkolla.

Neni 12

Para se të realizohet procedura për verifikimin e njohurive të nxënësit, për përfshirjen e tij më të lehtë në mësim, kryhet intervistë nga shërbimi profesional dhe një mësimdhënës i grupit klasor/lëndor, me qëllim mbledhjen e më shumë të dhënave për gjendjen socio-emocionale dhe njohjes e tij më të mirë.

Neni 13

Shkolla të paktën një javë para realizimit të testimit e njofton prindin/kujdestarin e nxënësit për ditën, vendin dhe kohën e verifikimit të njohurive të nxënësit.

Neni 14

Pas përfundimit të verifikimit të njohurive, Komisioni është i detyruar të hartojë procesverbal me rezultatet e testimit, i cili duhet të përmbajë: të dhënat për nxënësin, datën e realizimit të verifikimit, notën/rezultatit e verifikimit dhe vërejtjet për rrjedhën e testimit, nëse ka.

Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe dorëzohet tek drejtori i shkollës. Në bazë të rezultatit të testimit, nxënësi përfshihet në klasën përkatëse, ndërsa prindërit/kujdestarët e nxënësit informohen për vendimin e marrë.

Neni 15

Nëse në të njëjtën shkollë regjistrohen më shumë nxënës me kufirin e moshës së tejkaluar, ata nuk grupohen në të njëjtën paralele, por shpërndahen në mënyrë të barabartë në disa paralele.

Neni 16

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, ndalon së vlefshmi Rregullorja për mënyrën e regjistrimit të fëmijëve që nuk janë të përfshirë në mësim në arsimin fillor, ndërsa janë me kufirin e mosheës së tejkaluar, nr. 12-15044/2 të datës 24.12.2020.

Neni 17

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së sjelljes së tij.

Бр./Nr.18-13736/1

28.10.2025 година/viti

Скопје/Shkup

Министерка за образование и наука,

Ministre e Arsimit dhe Shkencës

проф. д-р Весна Јаневска, d.v.